



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 214, Datë 18.09.2025

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“NIKOLICA SKI RESORT” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.09.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2427/1 prot., datë 15.09.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “NIKOLICA SKI RESORT” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “NIKOLICA SKI RESORT” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2427 prot., datë 09.09.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali eolik, me kapacitet të instaluar 3 MW, me vendndodhje në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, Qarku Vlorë.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pikat 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas gërmave “a”, “b” dhe “c”, si dhe ka kryer pagesën e aplikimit sipas Aneksit A.
- Në përputhje me nenin 9, pikën 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas gërmës “a”.
- Në përputhje me nenin 9, pikën 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas gërmave “a” dhe “c”.

- Në përputhje me nenin 9, pikën 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas gërmeve “a”, “b”, dhe “e”. Ndërsa gërmat “d” dhe “f” nuk aplikohen për central eolik.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

- Shoqëria është pajisur me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 215, datë 13.04.2023 *“Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike eolike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në Tragjas, Njësia Administrative Oriku, Qarku Vlorë, nga shoqëria “NIKOLICA SKI RESORT” shpk”.*
- Shoqëria ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) kontratën nr. 1095 rep., nr. 606 kol., datë 14.02.2024 *“Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike eolik, me kapacitet prodhues 3 MW dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në Tragjas, Njësia Administrative Oriku, Qarku Vlorë, nga shoqëria “NIKOLICA SKI RESORT” shpk”, nënshkruar ndërmjet MIE-s dhe Mbajtësit të Miratimit për Ndërtim, shoqërisë “NIKOLICA SKI RESORT” sh.p.k.*
- Shoqëria ka marrë miratimin në parim për lidhjen e centralit me rrjetin e transmetimit nëpërmjet shkresës së OST sh.a., të datës 06.06.2022
- Shoqëria është pajisur me Vendimin për VNM Paraprake, lëshuar më 22.08.2025 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për zhvillimin e projektit *“Ndërtimi i impiantit gjenerues të energjisë elektrike eolike, me kapacitet të instaluar 3 MW, dhe veprave ndihmëse në zonën e Tragjasit, Vlorë”.*
- Në këtë aplikim shoqëria duhet të plotësojë/depozitojë dhe sa vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- Dëshminë e penalitetit të përditësuar, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për administratorin e shoqërisë. (gërma “b”)
- Shoqëria duhet të depozitojë informacion/dokumentacion mbi stafin aktual efektiv në strukturën e saj. (gërma “c”)

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- Dokument të përditësuar mbi gjendjen bankare të shoqërisë dhe vendimin e organeve drejtuese për dedikimin e shumës përkatëse nga fondet e veta për financimin e projektit. (gërma “b”)

Plan biznesi të përditësuar ku të ketë parashikime për kostot dhe të ardhurat për të gjithë afatin e vlefshmërisë së licencës. (gërma “c”)

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

2.1 Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- Informacion/dokumentacion në rast se shoqëria ka vijuar me krijimin e një shoqërie për qëllime të veçanta, sipas përcaktimeve të VKM nr. 215, datë 13.04.2023. (gërma “b”)

- Miratimin përfundimtar të pikës së lidhjes ose Marrëveshjen përkatëse të nënshkruar me OST sh.a., nëse shoqëria është pajisur me të, ose përgjigjen e OST sh.a. lidhur me kërkesën e bërë për lidhjen me rrjetin e transmetimit. **(gërma “c”)**
- Vlerësohet e nevojshme që të njoftohet AAC për fillimin e procedurës së licencimit të shoqërisë për një afat 30-vjeçar dhe të vihet në dijeni shoqëria në këtë shkresë, kjo në referencë të një korrespondence të zhvilluar më herët me Autoritetin e Aviacionit Civil, ku është kërkuar që në rastet kur një shoqëri aplikon për t’u pajisur në ERE me një licencë për kryerjen e këtij aktiviteti, të vihet në dijeni dhe Autoriteti i Aviacionit Civil, në mënyrë që të identifikohen në një hartë zonat ku do të vendosen objekte të tilla, për t’u ardhur në ndihmë operatorëve të ndryshëm gjatë aktiviteteve të ndryshme të lundrimit ajror,

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “NIKOLICA SKI RESORT” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali eolik, me kapacitet të instaluar 3 MW, me vendndodhje në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, Qarku Vlorë, për një afat 30-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “NIKOLICA SKI RESORT” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoritetin e Aviacionit Civil për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI